

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

**Për: MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

**Për Aktivitetin e Prokurimit:**

Nr1 i prokurimit	205-24-668-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Zgjerimi i rrugës Nacionale N 9, Prishtinë-Pejë, segmenti Dollc - Zahaq, Loti 1 ,3, 4**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**N.N.SH. "World Medium" & Ndërtimi Ing SHPK&Adea Construction SHPK & Rahovica Commerce SHPK & Linda**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bashkim Gashi, pn

(Adresa)

Malishevë

**24000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+383 49 599 007**

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

**BURIM ZABELAJ**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**n.n.sh.worldmedium@hotmail.com**

(Adresa elektronike)

**05.05.2025**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

*Prishtinë*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)*

*(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për Kontratë: 04.07.2024

Data e hapjes së ofertave: 10.10.2024

Njoftimi mbi vendimin dt.18.04.2025

Kërkesë për rishqyrtim: 23.04.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 25.04.2025

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 11 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 68 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim Publik.

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

#### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.04.07.2025, kurse hapja e ofertave është bërë me datë. 10.10.2025

Njoftimi mbi vendimin është bërë me dt. 18.04.2025, ku janë rekomanduar për kontratë operatorët ekonomik si më poshtë:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpërblen me kontratë Operatorëve Ekonomik si tenderi i përgjegjshëm me çmim me të lirë per Lote :

Lot 1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; ARLINDI SHPK; Berisha Company SH.A.,	9,099,176.46 Euro
Lot 2.	Grup i Operatorëve Ekonomik KOSOVA ASFALT SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.; GËRLICA - COMPANY SH. P.K.; AVAG GROUP SH.P.K.; ASFALT Corp. SH.P.K.; UDHA SHPK,	9,244,309.90 Euro
Lot 3.	Grup i Operatorëve Ekonomik JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; ILEAA - GR SH.P.K.; Albavia sh.p.k; BERISHA COM SH.P.K.,	10,620,889.43 Euro
Lot 4.	Grup i Operatorëve Ekonomik „Lika Trade Sh.p.k.; Lika Company SH.P.K.,	8,843,292.10 Euro

Ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar, ndërsa arsyeja e eliminimit është shënuar si më poshtë:

**Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ne dosje te tenderit tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ne piken 2.Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë 2,000,000.00euro duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin ne fjale ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin per te cilin lejohet kredia. Dëshmia 2.Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë original i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar.**

**OE NNSH WORLD MEDIUM e ka te prezentuar nje leter konfirmim nga banka, te cilen e njejta leter eshte e paraqitur edhe ne 3 tendere te tjera, njeri prej tyre eshte nenshkruar kontrata dhe si komisioni kemi kerkuar sqarim nga banka per te nejten leter konfirmim dhe pergjigjja e bankes ishte “se , klienti mjetet e kredis dhe ovd I ka shpenzuar per projekte te ndryshme, konfirmojm se klienti per momentin nuk I ka ne dispozicion keto mjete, si dhe ju konfirmojm se kjo nuk eshte nje Letermbeshtetje financiare po është vetëm konfirmim.”**

**Andaj nje kërkesë e tille nuk I përmbush kërkesat e FDT.**

Fillimisht sqarojmë se **për Lot 1** ne jemi kompania e dytë me çmim më të lirë, ku ne kemi ofertuar me çmim prej **8,617,670.70 €**, ndërsa OE më i lirë se sa oferta jonë është konzorciumi “Benita Company&Asfalt Group SHPK&Arfa Group Shpk&Fortesa SHPK&Saba Belca me çmim prej **8,555,000.00€**, mirëpo që ky konzorcium është i papërgjegjshëm me arsyet që do ti cekim më poshtë.

Për Lot 1 është rekomanduar për kontratë grupi i OE “**Pro&Co Group SHPK&Arlindi SHPK&Berisha Company SH.A**” me çmim prej **9,099,176.46 €**. Diferenca e çmimit ndërmjet konzorciumit tonë në raport me atë të konzorciumit të rekomanduar për kontratë është **481,505.76 €**.

**Për Lot 2** ne jemi kompania e dytë me çmim më të lirë, ku ne kemi ofertuar me çmim prej 9,532,555.21 €, ndërsa OE më i lirë se sa oferta jonë është konzorciumi “Kosova asfalt SHPK&El-Bau SHPK&Gërlica Company SHPK&Avag Group SHPK&Asfalt Corp SHPK&Udha SHPK” me çmim prej 9,244,309.90€, mirëpo që ky konzorcium është i papërgjegjshëm me arsyet që do ti cekim më poshtë.

**Për Lot 3** ne jemi të renditur me çmimin **ofertues më të lirë nga të gjithë ofertuesit**, ku ne kemi ofertuar me çmim prej 9,976,418.72 €, ndërsa është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Joos& Krasniqi Baze SHPK&Ileaa-Gr SHPK&Albavia SHPK&Berisha Com SHPK” me çmim prej 10,620,889.43 €. Diferenca e çmimit ndërmjet konsorciumit tonë në raport me atë të konsorciumit të rekomanduar për kontratë është **644,470.71 €**.

**Për Lot 4** ne jemi kompania e tretë me çmim më të lirë, ku ne kemi ofertuar me çmim prej 8,877,452.19 €, ndërsa OE më i lirë se sa oferta jonë është konsorciumi “Benita Company&Asfalt Group SHPK&Arfa Group Shpk&Fortesa SHPK&Saba Belca dega në Kosovë me çmim prej 8,200,000.01 € dhe konsorciumi “Lika TradeSHPK&Lika Company SHPK” me çmim prej 8,743,292.10 € mirëpo që të dy konsorciumet janë të papërgjegjshëm me arsyet që do ti cekim më poshtë.

**Për Lot 4** është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Lika TradeSHPK&Lika Company SHPK” me çmim prej 8,743,292.10 €.

Në këtë procedurë të prokurimit së pari kemi shkelje të afateve për vlerësim të ofertave, pasi që hapja e ofertave është bërë **me dt.10.10.2024** ndërsa njoftimi mbi vendimin B58 është publikuar me **dt.18.04.2025**, e që do të thotë se vlerësimi i ofertave ka zgjat mbi 6 muaj pra mbi 180 ditë, edhe pse afati për vlerësim të ofertave është 30 ditë, e ku mund të zgjatet në raste të jashtëzakonshme edhe për 20 ditë. Neni 40.3 i RRPP Nr.001/2022 e përcakton qartë:

*Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.*

Më lartë u përshkrua kronologjia në lidhje me konsorciumet e rekomanduar për kontratë për katër lotet, ndërsa sa i përket arsyes së eliminimit të konsorciumit tonë, sqarojmë se ne jemi eliminuar në kundërshtim të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht edhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Lidhur me arsyen e eliminimit përkitazi me kërkesën për kapital financiar, sqarojmë se gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime nga Banka Ekonomike, në lidhje me dëshminë/konfirmimin bankar, e që ne ishim njoftuar nga Banka për këto sqarim, ndërsa duke pa tendencën e autoritetit kontraktues, ne me dt.27.12.2024 i kemi dërguar një shkresë autoritetit kontraktues duke sqaruar se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet me dëshmitë dhe dokumentet që ne i kemi dorëzuar me rastin e ofertimit dhe se konfirmimi bankar ka qenë real dhe se ky konfirmim ka qenë në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit.

Se arsyeja e eliminimit është e pabazuar e paqëndrueshme dhe tendencioze do ta elaborojmë në vijim:

Kërkesa Nr.2 tek neni 8.1&8.2 i FDT-së është si në vijim:

**2.Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlere 2,000,000.00euro duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi te pa kushtezuar, nga një bankë duke emertuar projektin për të cilin lejohet kredia.**

**Dëshmia e kërkuar dokumentare**

**2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi te pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar.**

Duke u bazuar në këtë kërkesë, ne kemi dorëzuar dëshminë/konfirmimin nga Banka Ekonomike për kredinë e lëshuar nga kjo Bankë në shumë 600,000.00 euro, mbitërheqjen në vlerë prej 290,000.00 euro dhe 10,000.00

euro e që kishte të bënte me tenderin me titull-Zgjerimi i rrugës Nationale N9, Prishtinë-Pejë, segmenti Dollc Zahaq, Lot 1, 2, 3, 4, me Nr. prok:205-24-668-5-1-1.

Dëshmia nga Banka e lëshuar për ne, është plotësisht në harmoni me kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit, prandaj është dashur të merret parasysh dhe të shpallet fitues së paku në njërin Lot, pasi që kërkesa ka qenë e qartë se një OE mund të shpallet fitues vetëm në një Lot. Dëshmia nga Banka përmban elementet e kërkuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pasi që përmban titullin e projektit në fjalë dhe po ashtu vlera e kërkuar është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Konfirmimi i Bankës e mban **dt.17.07.2024**, pra në kohën e shpalljes së tenderit dhe përgatitjeve për ofertim. Fillimisht ju njoftojmë se çdo dokument i lëshuar para datës së ofertimit dhe i cili i ka plotësuar kushtet e kërkuara në momentin e ofertimit, është valid dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet me ato dokumente në raport me kërkesat e dosjes së tenderit, e që në këtë rast dokumenti i lëshuar nga Banka është valid, e që ne besojmë që edhe Banka iu ka konfirmuar një gjë të tillë autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues duke mos pasur mundësi të na gjej ndonjë gabim në dokumentacion merret me çështje jo esenciale dhe me kërkesa të cilat nuk kanë qenë në dosje të tenderit.

Neni 59.4 i LPP-së e përcakton qartë, citojmë:

“4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”

Përderisa kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që të ofrohet dëshmi nga kompania që ka mjete të gatshme në llogari apo qasje në kredi të pakushtëzuar dhe dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga banka dhe përderisa ne e kemi ofruar këtë dëshmi plotësisht (100%) sipas kërkesës së dosjes së tenderit, atëherë rezulton fakti se ne e kemi plotësuar këtë kërkesë, prandaj arsyeja e eliminimit është e pabazuar, e pa qëndrueshme dhe tendencioze dhe në kundërshtim me kërkesën dosjes së tenderit.

Eliminimi i konsorciumit tonë bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, sepse jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e cekur në dosje të tenderit, pasi që askund në dosje të tenderit nuk ka qenë e përcaktuar që kredia nuk duhet të jetë e shpenzuar deri sa të nënshkruhet kontrata apo deri sa të shpallet fituesi.

Një kërkesë të tillë që kredia nuk duhet të jetë e shpenzuar derisa të nënshkruhet kontrata është përcaktuar në një tender tjetër nga autoriteti kontraktues, me titull “Ri tender-Zgjerimi i Rrugës Nationale N9-Segmenti Kijevë-Dollc, Loti 1, St 0+000-4+000 me gjatësi L=5,330.60m” me nr. prok: 205-25-2216-5-1-1, i publikuar me dt. 21.03.2025 ku dëshmi e kërkuar dokumentare ka qenë e përcaktuar si më poshtë:

**“Kapitali financiar i paraqitur për realizimin e projektit nuk guxon të shfrytëzohet deri në nënshkrimin e kontratës”.**

Në këto raste kur ekziston një kërkesë e tillë në FDT atëherë edhe vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform kërkesave dhe në tenderin për të cilin e cekëm që ekziston një kërkesë e tillë mund të eliminohen operatorët ekonomik nëse nuk e plotësojnë këtë kërkesë, mirëpo ky standard nuk mund të përdoret kur nuk ekziston kërkesa e tillë në dosje të tenderit e siç është rasti me tenderin për të cilin po parashtrojmë ankesë. Pra ka dallim në kërkesa të dosjes së tenderit.

Pra, ne jemi eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe ky veprim i AK-së, përveç se përbën diskriminim të theksuar ndaj konzorciumit tonë, shpërfaq edhe tejkalim të autorizimeve të komisionit vlerësues, e të cilat veprime shpijnë në pasiguri juridike për bizneset e përgjegjshme dhe të cilat kanë stabilitet ekonomik dhe financiar dhe që kanë përvojë shumë të madhe në këtë lëmi. Realisht veprimi i komisionit vlerësues shpërfaq epërsinë e veprimeve të tyre në raport edhe me legjislacionin në fuqi dhe e humb rëndësinë e kërkesave të dosjes së tenderit.

Kjo arsye e eliminimit të konsorciumit tonë dhe ky vlerësim i ofertave tregon që komisioni vlerësues në MMPHI janë mbi ligjin, pasi që veprimet e tyre janë në kundërshtim me LPP dhe vlerësimet e tyre nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Në këtë rast ZPP është dashur të veprojë në kuadër të autorizimeve të tija

ligjore edhe pse kjo procedurë është zhvilluar në periudhën kur ZPP nuk ka qenë në këtë pozitë. Thjesht është dashur të parandalohet veprimet e kundërligjshme të komisionit vlerësues.

Pavarësisht këtyre veprimeve, ne jemi të bindur se këto shkelje ligjore do të konfirmohen nga institucionet dhe organet tjera kompetente, ndërsa nëse nuk korrigjohen, ne jemi të përkushtuar që drejtësinë ta kërkojmë në çdo institucion administrativ dhe penal me qëllimin e vetëm që të respektohen të drejtat tona dhe të respektohen kërkesat e dosjes së tenderit, e të cilat kërkesa vetë MMPHI i ka vendos në dosje të tenderit.

Në shpresojmë shumë që OSHP-ja do të korrigjojë veprimin e autoritetit kontraktues.

Se si duhet të bëhet vlerësimi i ofertave dhe në cilat kritere duhet bazuar përcaktohet qartë edhe tek neni **40.2 i RRPP Nr.001/2022**, ku ceket si në vijim :

**“Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.**

Me këtë dispozitë, përcaktohet qartë se autoritetet kontraktuese nuk mund të **heqin, ndryshojnë, modifikojnë** ose **të shtojnë kritere** dhe kërkesa me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Me rastin e vlerësimit të ofertës së konzorciumit tonë janë **shtuar kërkesa**, siç është kjo që linjat kreditor të mos jetë e shpenzuar derisa të bëhet njoftimi mbi vendimin B58. Ky veprim i komisionit vlerësues tregon arbitrarizëm në vlerësim dhe diskriminim për konsorciumin tonë.

Në këtë rast kemi tejkalim të autorizimeve nga ana e komisionit të vlerësimit dhe vlerësim në kundërshtim me kriteret e dosjes së tenderit, ndërsa tejkalimi i autorizimeve përbën edhe vepër penale në kuadër të keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas nenit 414 të KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 06/L-074.

Këto keqpërdorime ne jemi të obliguar ti bëjmë publike në institucionet e drejtësisë dhe nëpër media, nëse eventualisht nuk do të bëhet rivlerësimi në bërë të kriterëve dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Tendenca diskriminuese ndaj kompanisë tonë vërehet tek arsyeja e eliminimit, ku ceken edhe dëshmitë nga Banka që janë dorëzuar në procedura të tjera të prokurimit. Çdo tender është procedurë e veçantë dhe me kërkesa e specifika të ndryshme, prandaj autoriteti kontraktues nuk është dashur të merret me procedurat tjera të prokurimit, pavarësisht se a janë zhvilluar nga ky institucion apo jo.

Në arsyen e eliminimit autoriteti kontraktues më pastaj e ka shënuar se dokumenti nga Banka nuk është letër mbështetje nga por konfirmim, prandaj nga ky arsyetim në thojza vërehet një tendencë diskriminuese ndaj konsorciumit tonë, pasi që autoriteti kontraktues në mungesë për të arritur qëllimin e tyre për ndonjë mangësi në ofertën tonë, merret me terminologji të emërimit të dokumenteve e jo me thelbin dhe me çështjet kryesore dhe përmbajtjesore që dëshmojnë përmbushjen e kërkesës së dosje s së tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk ka shfrytëzuar në mënyrë të drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së për të kërkuar sqarime eventuale, mirëpo në mënyrë arbitrare dhe tendencioze kane tejkaluar kompetencat e tyre të përcaktuara me LPP, konkretisht kryetarja e komisionit Aferdita Shkoreti dhe zyrtari i prokurimit Jetmir Alaj, kanë marr rolin e hetuesise duke hulumtuar tenderet paraprak si dhe kanë kerkuar në mënyrë të paligjshme informata sensitive dhe sekrete të llogarise bankare (te cilat jane te elaboruara edhe ne parashtresen e dates 27.12.2024 te cilen e kemi percjelle ne emailat e ketyre zyrtareve si dhe e kemi ngarkuar ne webfaqen e e-prokurimit, e qe edhe kete parashtrese me dokumente percjellëse e kemi bashkangjitur me kerkesë për rishqyrtim e po e bashkangjesim edhe me ankesë).

Nga sqarimet dhe dëshmitë që i cekëm më lartë, shumë qartë shihet tendenca e autoritetit kontraktues për të na eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe që realisht veprimi i AK-së bie në kundërshtim të plotë me nenin 56.3 të LPP-së.

**Grupi i OE “Pro&Co Group SHPK&Arlindi SHPK&Berisha Company SH.A” është i papërgjegjshëm më arsye që do ti elaborojmë më poshtë:**

1.Në dosje të tenderit është kërkuar “10. OE duhet te jete i licencuar me leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës betonit, bazës asfaltit dhe **OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr**”.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar marrëveshjen me kompaninë Guri SH.P.K., të cilës marrëveshje ja ka bashkangjitur edhe licencën. Kur analizohet licenca e prezantuar shihet qartë se kompania Guri SH.P.K., nuk është e licencuar si gurëthyes zhavorr, mirëpo është e licencuar si sortues. Përderisa KPMMLëshon licenca të veçanta për sortues dhe licenca të veçanta për gurëthyes-zhavorr, atëherë kuptohet qartë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e lartcekur.

Gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nga qasja që kemi pasur, e kemi vërejtur që grupit të OE të rekomanduar për kontratë i janë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me pozicionet 2, 3, 5 dhe 6 në lidhje me pajisjet e specifikuara tek aneksi 1, ku është kërkuar që të ofrohen dëshmi për të njëjtat pajisje/pozicione përkatësisht të prezantohen specifikat teknike tek kovat e eskavatorit dhe pesha në m<sup>3</sup> për ngarkuesit nuk është specifikuar. Nga qasja që kemi pasur neve, nuk na është ofruar ndonjë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dëshmi konkrete në lidhje me pajisjet e specifikuara më lartë, andaj përderisa nuk kemi ndonjë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dëshmi konkrete konform kërkesës së dosjes së tenderit ne dyshojmë që i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Tek aneksi 1 përkatësisht te lista e pajisjeve të kërkuara tek kërkesa me nr. rendor 2 dhe 3 është kërkuar “**Eskavator, me kapac. deri në 2.0m<sup>3</sup>-5 copë; Eskavator, me kapac. mbi 2.0 m<sup>3</sup> -2 copë**”.

Nga dëshmitë e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë askund nuk figurojnë dëshmitë në lidhje me kapacitetin e kovës, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit “**Gjithashtu të open karakteristikat gjegjesisht specifikat teknike të veçanta per secilen nga paisjet qoftë per koven (lugën) e eskavatorit ngarkuesit dhe kapacitetin e tyre dhe te dhenat e nevojshme per evidentimin sa me te sakt te paisjeve sipas kerkeses. Dëshmit duhet te jene te dukshme**”. Përderisa nuk janë ofruar dëshmitë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, atëherë kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të cilësohet edhe nga ana e AK-së dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Në të gjitha marrëveshjet e prezantuara shënon teksti si në vijim:

7.Tek lista e pajisjeve tek kërkesa me nr. rendor 8 është kërkuar “ 8 Cilindër min. 12t me dhëmbëza, vibrues -3 copë”.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë kërkesën e lartcekur për faktin se nga dëshmitë e prezantuara në ofertën e tyre përkatësisht në dudat doganor, askund nuk figurojnë që cilindrat e prezantuar janë me **dhëmbëza**, mirëpo në dud ceket që të njëjtit janë **vetëm vibrues**. Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar vetëm një cilindër i cili është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo i njëjti nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse në kërkesë është specifikuar saktë që duhet të **prezantohen 3 copë** dhe jo vetëm një.


Andaj si përfundim grupi i OE të rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm sepse nuk kanë ofruar dëshmi konkrete që posedojnë cilindra **me dhëmbëzor-vibrues** dhe si të tillë është dashur të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit.

Tek lista e pajisjeve, kërkesa me **numer rendor 15** është kërkuar **cilindra me rrota te kombinuara** (gome dhe hekur) minimum 6 ton, 2 cope, kurse nga ana e OE te rekomanduar per kontrate, jane prezantuar cilindra, te cilet me te dhenat e prezantuara rezultojne te jene **cilindra per zhavor dhe jo per asfalt**, ashtu sic eshte

kerkuar sipas dosjes se tenderit. Sa per ilustrim po ju prezantojme llojet e cilindrave të cilët OE i rekomanduar per kontratë i ka prezantuar, si dhe nje ilustrim (shembull) se si duhet te jen cilindrati sipas kerkese se Dosjes se Tenderit:


### 15.1

**Tek Kjo pike OE ka prezantuar cilinder te tipit HAMM, 3011D, vp 1996 (nga kerkimi ne google del qe ky lloj cilindri eshte i destinuar per ngjeshje te zhavorit dhe jo te asfaltit).**



### 15.2

**Tek Kjo pike OE ka prezantuar cilinder te tipit HAMM 3412 HT, vp: 2007 (nga kerkimi ne google del qe ky lloj cilindri eshte i destinuar per ngjeshje te zhavorit dhe jo te asfaltit).**



### 15.3

**Tek Kjo pike OE ka prezantuar cilinder te tipit DYNAPAC CA 301, vp: 1993 (nga kerkimi ne google del qe ky lloj cilindri eshte i destinuar per ngjeshje te zhavorit dhe jo te asfaltit).**





Page 11 nga14

Përgjigja AK-së se mjetet e kredisë janë shpenzuar për projekte të ndryshme dhe se kinse ne nuk e kemi përmbushur kërkesën e përcaktuar në FDT është arsyetim joprofesional, i njëanshëm dhe tendencioz për faktin se në dosje të tenderit nuk ka qenë kërkesë që mjetet të mos shpenzohen deri sa të nënshkruhet kontrata apo deri sa të bëhet vlerësimi i ofertave.

Vetë kërkesa ka qenë që të OE të kanë mjete të gatshme në llogari apo qasje në kredi të pakushtëzuar, prandaj në asnjë kërkesë nuk është përcaktuar që nëse mjetet i ka në dispozicion të mos shpenzohen deri në një periudhë të caktuar. Po ashtu qasja në kredi nuk është garancë dhe siguri që mjetet janë në llogari por që do të mbështetet kompania për këtë projekt, prandaj autoriteti kontraktues ka tejkaluar kërkesat e dosjes së tenderit me të vetmin qëllim për të na diskriminuar neve dhe për të na pamundësuar fitimin e kontratës.

Të gjitha kërkesat tjera që janë vendosur në dosje të tenderit kanë të bëjnë me dëshmi për përvojë të punës së kompanisë, me kapacitet teknik dhe profesional duke përfshirë edhe stafin në dispozicion e po ashtu edhe kërkesat në lidhje me kapacitetin ekonomik financiar, prandaj të gjitha këto kërkesa janë plotësuar nga ne e po ashtu edhe dëshmia nga Banka, mirëpo nëse eventualisht AK-së ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me sigurinë e përmbushjes së kontratës ka mundur të parashtrojë ndonjë pyetje e edhe të kërkojë rritjen e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, edhe pse ne jemi me çmime reale të tregut dhe nuk ka pasur arsye për një kërkesë të tillë. Këtë po e përmendim si dëshmi se AK-së nuk ka pasur ndonjë dilemë për përmbushje të kontratës por veprimi i tyre tregon tendenca diskriminuese ndaj konsorciumit tonë.

Në lidhje me pretendimet për papërgjegjshmërinë e grupit të OE të rekomanduar për kontratë për Lot 1 “Pro&Co Group SHPK&Arlindi SHPK&Berisha Company SH.A”, autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Andaj bazuar në pretendimi tuaj i njëjti është i pa bazuar dhe njëherit refuzohet ky pretendim.

**Përgjigje në lidhje me pretendimin e ngritur**

Gjate shqyrtimi të gjitha pika të ankimit dhe duke parë se edhe OE tjerë pjemarrës në këtë tender e kanë atakuar LOT 1 AK lenden për këtë lot do ta kthejë në rivlerësim.

**Andaj kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet.**

Andaj, konsiderojmë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës– Divizioni i Prokurimit, ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, konform Rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, mbi përcaktimin e kriterëve në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Realisht, nuk kemi shqyrtim të pretendimeve tona ankimore nga ana e AK-së, prandaj edhe refuzimi i kërkesës për rishqyrtim është jo profesional dhe tendencioz, e po ashtu mos arsyetimi i refuzimit bie në kundërshtim me nenin 10/A paragrafi 9 i LPP-së ku shkruan qartë “9.Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtuesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Autoriteti kontraktues nuk ka shfrytëzuar nenin 59 dhe 72 të LPP-së për të kërkuare sqarime nëse më të vërtet ka pasur dilema në lidhje me ndonjë dëshmi të ofruara nga ne edhe pse gjithçka ka qenë e qartë sa i përket përmbyshjes së kërkesave nga ana jonë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, dhe dyshimet tona të ngritura, konsiderojmë se OE të rekomanduar për kontratë nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe si të tillë janë të papërgjegjshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohen për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse neve jemi eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, ndërsa AK-së rekomanduar për kontratë OE për të cilët janë të papërgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të nxjerr:

## VENDIM

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e grupit të OE OE N.N.SH. **"World Medium" & Adea Construction SHPK & Rahovica Commerce SHPK & World Medium**
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 5,000.00 euro.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të *“Njoftimit për Kontratë”* apo *“Njoftimit për Konkurs të Projektimit”*.
- b) një kopje të publikimit për *“Njoftimin e Dhënies së Kontratës”* apo *“Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”* apo *“Njoftimit për Anulim”*.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

**Parashtresa e datës: 27.12.2024 dërguar AK**

**Letra standarde për tenderues të eliminuar dt: 18.04.2025**

**Kërkesa për rishqyrtim dt:23.04.2025**

**Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:25.04.2025**

**Anekset e apostrofuara**

**\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**